

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues dhe Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Besnike Miftari, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve F.D., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 4, në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nën par. 3 të KPK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK-së, të akuzuarve M.H., I.H. dhe A.H. për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentativë në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesat e mbrojtësve të akuzuarit F.D., av. M.H., ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I.H., av. M.B., ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.H., av. M.N. dhe ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar N.R.-H., av. E.K., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.405/2015, të dt.08.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.06.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesave të Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, dhe të përfaqësuesit të palës së dëmtuar N.R.-H.-H., av. E.K. dhe me aprovimin e pjesërishtëm e ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit I.H., av. M.B., sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.405/2015, te dates 08.02.2015, përkitazi me cilësimin ligjor dhe vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarit I.H., për veprën penale të vrasjes në tentativë të kryera në bashkëkryerje, nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, e më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit, i cilëson në veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 155 par. 1 të KPK-së, dhe ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, e në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt. 05.09.2009 deri më dt. 04.03.2010, ndërsa, të akuzuarve M.H. dhe A.H., i shqipton dënimin me burgim secilit veç e veç prej nga 5 (pesë) vjet, e në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 05.09.2009 deri më datën 27.08.2014.

II. Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të akuzuarit M.D., av. M.H., të akuzuarit A.H., av. M.N.i dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, PKR.nr.405/2015, te datës 08.02.2015, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.405/2015, i dt. 08.02.2015, të akuzuarit F.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 4 në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nën par. 3 të KPK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK-së, dhe është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 05.09.2009 deri më dt. 14.10.2014, ndërsa, të akuzuarit, M.H., I.H. dhe A.H., për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentative në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, i gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjet e 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do t'iu llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, të cilat dënime të akuzuarit do t'i paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë:

Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarve F.D., M.H., I.H. dhe A.H., t'iu shqiptojë dënime me të larta me burgim.

Ankesë ka paraqitur edhe përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës N.R.-H.-H., av. E.K., me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë, ta anulon dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.D., av. M.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë, ta anulojë dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.H., av. M.B., për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë, ta aprovojë dhe të akuzuarin ta lirojë nga dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. M.N.i, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë, ta ndryshojë dhe të akuzuarit A.H.n ta lirojë nga akuza apo ta shpall fajtor për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 155 par. 1 të KPK-së, ose që aktgjykimin e ankimuar ta anulon dhe çështjen penale ta kthen në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj, PPA/I.nr.259/2018, të dt.11.06.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Prishtinë dhe ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar N.R.-H.-H., av. E.K., dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve F.D., av. M.H., I.H., av. M.B., dhe A.H., av. M.N.i, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PTH - DKR në Prishtinë dhe e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR në

Prishtinë, PKR.nr.405/2015, i dt. 08.02.2015, të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim dhe të akuzuarve t'iu shqiptohet dënim me burgim efektiv. Ndërsa, të refuzohen ankesat e parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve F.D., av. M.H., I.H., av. M.B., dhe A.H., av.M.N.i si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 390 par. 1 caktoi seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. E.K., të dëmtuarit M.D., R.D. dhe E.d., i akuzuari F.D., dhe mbrojtësi i tij av. M.H., i akuzuari M.H., i akuzuari I.H., dhe mbrojtësja e tij av. M.B. si dhe i akuzuari A.H., ndërsa, nuk kanë marrë pjesë Prokuroria e Apelit – DKR në Prishtinë, e dëmtuara N.H., E.H., mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. M.N., dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre në pajtim me dispozitën e nenit 390 par. 4 të KPK-së, ngase, pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 384 par. 1 të KPP-së, edhe sipas pretendimeve ankimore të PTH-DKR në Prishtinë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar av. E.K., të mbrojtësve të akuzuarve F.D., av.M.H., I.H., av. M.B. dhe A.H., av. M.N., e duke marrë parasysh edhe vendimin e Prokurorisë së Apelit, - DKR në Prishtinë, si dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, e përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe e mbrojtëses të akuzuarit I.H. janë pjesërisht të bazuara, ndërsa, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.D., dhe A.H., janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë në ankesën e saj, pretendon se gjykata me rastin e matjes së dënimit të akuzuarve M.H., I.H. dhe A.H., iu ka shqiptuar dënime shumë të buta të cilat dënime nuk janë adekuate me peshën e veprës penale dhe përgjegjësini penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, gjykata nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese dhe nuk ka marrë parasysh faktin se të akuzuarit janë fqinjë të njëjtit fshat, dhe se gjerë te vrasja ka ardhur për shkak të rrahjes së mëparshme që ka ndodhur një ditë më parë, dhe se rasti ku ka ndodhur ngjarja ka pasur persona tjerë ku ka mundur të ketë pasoja edhe për ta.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar N.R.-H. i, av. E.K. në ankesën e tij pretendon se gjykata të akuzuarin F.D.n, e ka gjykuar me dënim unik në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) viteve dhe dënimi në krahasim me vlerën e mbrojtur-jetën e njeriut, me ç'rast është privuar i ndjeri Q.H., është i butë dhe gjykata me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit F., nuk do të arrihet qëllimi i dënimit si pasojë e veprimeve kundërligjore të akuzuarit F.. Mbrojtësi i të akuzuarit F.D., av. M.H., në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par. 7 të KPP-së, për arsye se gjykata nuk ka dhënë asnjë fakt vendimtar se cilave prova iu ka besuar, me rastin e shpalljes fajtor të akuzuarit F.D., për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 4, në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nën par. 3 të KPK-së, ankesa pretendon se i akuzuari F.D., ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, nga sulmi i të akuzuarve të familjes H., të cilët janë futur në autobus, dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Kjo për arsye se nga gjendja faktike dhe plagosjes së E.H.t si udhëtar i rastit, qartë del se këtu kemi të bëjmë që me vetëgjyqësi dhe kanun të zgjidhjen e problemeve mes dy familjeve të cilët më parë kanë pasur mosmarrëveshje, për arsye se nga deklaratat e M.D.t, R.D.t, E.d.t dhe F.D. rezulton se familja H.i-të akuzuarit kishin përgatitur planin përpara të miturin F.D.n i cili gjendej në autobus, dhe i njëjti kur është gjetur në një situatë të tillë ai është mbrojtur nga sulmi nga të akuzuarit e të cilat veprime janë në kuadër të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 par. 1 dhe 2 të KPK-së, edhe vendimi mbi dënimin për veprën

penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor është tejet i lartë dhe nuk ka mbështetje në ligj, duke i marrë parasysh rrethanat në momentin kur është kryer vepra penale dhe në situatën kur është kryer vepra penale, e i akuzuari F. duke vepruar në kuadër të mbrojtjes së nevojshme, ndërsa sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 i KPK-së, dënimi i shqiptuar është tejet i lartë.

Mbrojtësja e të akzuarit I.H., av. M.B., në ankesën e saj pretendon se është shkelur ligji penal në dëm të akzuarit I.H., për arsye se gjykata nuk ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka qenë pasagjer në kombi dhe nuk ka vendosur që të del para autobusit, nga kombi kanë dalë të gjithë të akzuarit përveç të akzuarit Isuf, i cili ka qëndruar në kombi dhe nuk ka dashur t'iu bashkëngjitet personave tjerë, mirëpo kur ka dëgjuar krismat nuk ka mundur të jetë indiferent, e ka marrë teslicën të cilën e ka pasur si mjet pune dhe kur ka vërejtur se i akuzuari F. ka qëlluar në këmbë të akzuarin A.r, ka reaguuar I.H. me qëllim që mos të ndodhë ndonjë tragjedi edhe më e madhe reagimet e tij në këtë pjesëmarrje kanë qenë normale për qetësimin e situatës e cila ka ndodhur, edhe vendimi mbi dënimin është i lartë, për arsye se i akuzuari në këtë rast është munduar që të qetësojë situatën dhe veprimet e tija nuk mbulojnë një dënim të lartë të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akzuarit A.H., av. M.N.i, në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është i përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1, 1.8, 1.10 dhe 1.12, e në lidhje me nenin 370 par. 6, 7 dhe 8 për arsye se gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron veprimet e të akzuarit si të kundërligjshme. I akuzuari A., sipas ankesës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që do të përmbushin elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, i akuzuari nuk ka pasur as dashje as motiv që të kryejë veprën penale pasi që as ai personalisht e as familja e tij nuk kanë pasur asgjë me familjen e të akzuarit F.D.. Ankesa pretendon se në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, eventualisht mund të formohen elementet e veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së. Në ankesë pretendohet se gjykata nuk ka aplikuar drejtë në dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me vendimin mbi dënimin, për arsye se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese të cilat kanë ekzistuar në kohën kur është shqiptuar dënimi, ndërsa, te rrethanat rënduese janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe këto kanë ndikuar që vendimi mbi dënimin për të akzuarit A. do të jetë jo i drejtë.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të PTH-DKR në Prishtinë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, të mbrojtëses të akzuarve F.D., M.H., I.H. dhe A.H., e edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 384 par. 1 nën par. 1.12 e në lidhje me nenin 6 dhe 7 të KPP-së, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës penale të cekura më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 4, në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nën par. 3 të KPK-së, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, për të akzuarit F.D., dhe për veprën penale të vrasjes të kryer në bashkëkryerje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 për të akzuarit M.H. dhe A.H., (përveç I.H.) gjykata ka dhënë arsyet e qarta dhe të plota rreth argumentimit të kryerjes së veprave penale nga të akzuarit e të cilat janë cekur më lartë. Për të akzuarin F.D., këto fakte mbështeten se pas sulmit nga i akuzuari F.H., dhe pasi ka pushuar sulmi i akzuarit F. shtënë me armë dhe e godet të ndjerin Q.H., i cili ka qenë në autobus, duke vepruar në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme, pas sulmit i cili është bërë nga të akzuarit F.,B.,M. dhe A., të cilët e kishin ndalur autobusin dhe ishin futur në autobus, e të cilët kishin pasur konflikt më parë, i akuzuari F., me pistoletë në dorë i është drejtuar familjes së D., që të zbresin poshtë nga autobusi dhe me pistoletë e qëllon të dëmtuarin R.D., dhe në atë moment i akuzuari F.D., për të zmbarsur sulmin e atëçastshëm prej vetes

nxjerrë nga brezi pistoletën dhe shkrep në drejtim të akuzuarit F. H. dhe pasi i akuzuari F., ndalet dhe pushon sulmin kundër të akuzuarit F., i njëjti shtënë në drejtim të Q.H.t i cili ka qenë në autobus dhe i shkakton lëndime vdekjeprurëse, në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, këto fakte mbështeten nga dëshmitë e dëshmitarëve të cilët kanë qenë prezent në autobus se pas hyrjes së të akuzuarve F., Xh.,B.,M. dhe A.H., në autobus, dhe pasi i akuzuari F. shkrep në drejtim të këmbëve të R.D.t, të cilit i shkakton lëndime trupore të rënda, e pastaj, në një situatë për të zmbarsur sulmin dhe pas pushimit të sulmit nga i akuzuari F., i akuzuari F. shkrep me armë dhe e qëllon të ndjerin Q.H., i cili ka qenë në autobus, duke i shkakuar plagë vdekjeprurëse e të cilat veprime të akuzuarit mbështeten nga raporti i autopsisë për të ndjerin Q.H., nga ekzaminimi kriminalistik i armëve të zjarrit, nga fotodokumentacioni si prova materiale dhe nga mendimet e ekspertëve mjeko ligjor për të dëmtuarit R.D., M.D. dhe E.H., të cilët mbështeten në ekspertizën e Dr. T.G., se i akuzuari F.H. ka pasur revolen në dorë i cili e kishte goditur me dy predha në këmbë të dëmtuarin R.D., e me të cilën vërtetohet se i dëmtuari R.D., ka pësuar një plagë tejkuese me armë zjarri në anën e poshtme të djathtë të kofshës së djathtë të cilat klasifikohen si dëmtime të rënda trupore, e të cilat plagë si rezulton nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, se në drejtim të dëmtuarit ka shkrepur i akuzuari F.H. dhe nga deklaratat e dëshmitarit E.d., e cila kishte identifikuar F.H., i cili ka hyrë nga dera në autobus, e të cilat fakte i mbështetin edhe deklaratat e dëshmitarit A.J., e cila deklaroi se ishin hapur dyert e autobusit dhe në autobus janë futur pjesëtarët e familjes H., dhe aty kishte filluar përlëshja në mes tyre, ku në autobus kanë qenë rreth 50 udhëtar, e cila fakte mbështeten edhe me deklaratën e V.H., se të akuzuarit kanë pasur ngatërresë të mëparshme, dhe të akuzuarit nga familja H. kanë dalë nga kombi e i cili ka qenë i ndalur në mes të rrugës, dhe e kanë ndalur autobusin dhe janë futur brenda ku kanë qenë anëtarët e familjes D., dhe janë dëgjuar krismat e armëve, dhe se të akuzuari e familjes H. janë futur në autobus i vërteton edhe i dëmtuari R.D., të njëjtat i vërteton në mënyrë identike edhe dëshmitari F.J., e për më tepër të gjithë të akuzuarit të cilët kanë hyrë në autobus kanë qenë të përgatitur, për mosmarrëveshje të cilët kanë pasur edhe me herët dhe pas pushimit të sulmit nga ana e të akuzuarve të familjes H., i akuzuari F.D. në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme shkrep dhe e godet të ndjerin Q.H., i cili ka ndërruar jetë në Qendrën Emergjente në Prishtinë.

Nga ajo që u tha më lartë, rezulton se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve rezulton se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 në lidhje me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesa e të cilat sipas kësaj baze ankimore janë të pabazuara. Gjykata vendimin e saj e ka bazuar në provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor se i akuzuari F.D., më dt. 05.09.2009, pasi që të akuzuarit M.H., I.H. dhe A.H., dhe të akuzuarit F.H., B. H. dhe Xh. H., të cilët gjenden në arrati, për shkak të mosmarrëveshjes të mëhershme që kanë pasur me familjen D., një vjet më parë e kanë ndalë autobusin, kanë hyrë brenda të armatosur dhe me mjete tjera dhe i akuzuari F.H. me pistoletë në dorë pasi iu kërcënohet familjes D., të cilët kanë qenë në autobus ku ka pasur edhe udhëtar, shkrep në këmbën e të dëmtuarit R.D., të cilit i shkakton lëndime plagë tejkuese me armë zjarri në anën e poshtme të djathtë të kofshës së djathtë të cilat klasifikohen si dëmtime të rënda trupore, ndërsa, menjëherë për ta larguar sulmin e atë çastshëm i cili kishte pushuar, i akuzuari F.D., nxjerr pistoletën, dhe në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme shtënë njëherë në drejtim të këmbëve të akuzuarit F.H., e pastaj shkrep edhe një plumb i cili e godet të ndjerin Q.H., i cili kishte qenë në autobus, pas marrjes së goditjeve nga plumbi, i njëjti vdes në Qendrën Emergjente në Prishtinë, dhe të gjithë të akuzuarit F.H., M.H., A.H., B. H. dhe Xh. H., ishin të përgatitur me mjete për ta privuar nga jeta familjen e D., të akuzuarin F.D., dhe të dëmtuarin R.D.n, e gjithë kjo gjendje faktike mbështetet nga dëshmitë e dëshmitarëve, raportet e autopsisë nga zyra për persona të zhdukur

dhe mjeksi ligjore për të ndjerin Q.H., të dt. 05.09.2009, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, nga ekspertiza mjeko ligjore për të dëmtuarin R.D., M.D. dhe E.H., të cilët janë dhënë nga eksperti mjeko ligjor Dr. Tefik Gashi, si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve A.J., F.J., deklaratave të dëmtuarve M.D., R.D., se të akuzuarit F.D., M.H. dhe A.H., kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor e të cilët janë vërtetuar nga dëshmitarët dhe të dëmtuarit të cilët kanë përshkruar tërë ngjarjen dhe të akuzuarit F.D., M.H. dhe A.H. (përveç të akuzuarit) M.H., kanë kryer veprat penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe gjykata gjendjen faktike nga gjykata është e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga përshkrimi faktik i veprave penale, objekti i aktgjykimit të ankimuar e më afër të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e që ka të bëjë me veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 par. 1 nën par. 4 në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nën par. 3 të KP të Kosovës, për të akuzuarin F.D., për veprën penale të vrasjes në tentativë të kryer në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KP të Kosovës, për të akuzuarit M.H. dhe A.H., gjykata drejtë ka aplikuar ligjin penal se me veprimet e tre të akuzuarve formohen elementet e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë, ndërsa, nga dispozitivi i aktgjykimit dhe përshkrimi faktik i saj lidhur me të akuzuarin I.H., dhe provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor rezulton se i akuzuari Isuf nuk ka shkuar fare menjëherë në autobus bashkë me të akuzuarit F.H., M.H., B. H., Xh. H. dhe

A.H. por ka qenë jashtë në kombi dhe pastaj, është futur në autobus dhe duke marrë parasysh se në këtë ngjarje kanë marrë pjesë shumë persona dhe i akuzuari Isuf ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes dhe ka marrë pjesë aktive në mes të akuzuarve të cekur më lartë, në veprën penale të vrasjes në tentativë të kryer në bashkëkryerje me të akuzuarit F.I, M., B., Xh. dhe A.H., Gjykata e Apelit, e ndryshoi aktgjykimin për arsye se nuk ekzistonte dashja tek i akuzuari I.H., dhe me veprimet e tija nuk ekziston elementi i kryerjes së veprës penale të vrasjes në tentativë, dhe veprimet e tija Gjykata e Apelit, i cilësoi në kuadër të veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 155 par. 1 të KPK-së, për të cilën vepër edhe e shpalli fajtor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sa i përket marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese për të akuzuarit F.H. dhe A.H., e duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe vlerën e mbrojtur për arsye se të akuzuarit M.H., dhe A.H., bashkë me të akuzuarit F.I, B. dhe Xh. H., të cilët gjenden në arrati, e duke mos vlerësuar në mënyrë të drejtë se si shkaktar të privimit nga jeta të ndjerit Q.H., ka qenë të akuzuarit e familjes H., ndërsa i akuzuari F.D., ka vepruar në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme për të cilin gjykata drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Sipas Gjykatës e Apelit, si pasojë e mosvlerësimit të drejtë të rrethanave gjatë kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarve M. dhe A.H., dhe mos vlerësimit të drejtë të rrethanave rënduese pjesëmarrjen e tyre në kryerjen e veprës penale, dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, Gjykata e Apelit, ia ashpërsoi dënimet dhe të akuzuarve M. dhe A.H., iu shqiptoi secilit veç e veç dënimet me burgim në kohëzgjatje prej nga 5 (pesë) vjet, e të cilat dënime janë me proporcion me peshën e veprës penale dhe me sjelljet e të akuzuarve të cilët vetë kanë shkuar me kombi, e kanë ndalë autobusin ku kanë qenë i dëmtuari R.D. dhe i akuzuari F.D., e në prezencën e këtyre rrethanave të akuzuarit e familjes H., kanë shkuar dhe janë futur në autobus me qëllim që ti pastrojnë mosmarrëveshjet e mëparshme të cilat i kanë pasur më herët me revole dhe me mjete tjera i sulmojnë të dëmtuarin R., dhe të akuzuarin F., i cili në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme e ka privuar nga jeta të ndjerin Q., i cili ka qenë udhëtar në autobus, e në prezencën e këtyre rrethanave gjykata ua ashpërsoi dënimet duke iu shqiptuar dënimet me burgim secilit veç e veç në kohëzgjatje prej nga 5 (pesë) vjet, e në të cilat dënime janë llogaritur koha e kaluar në paraburgim

dhe arrest shtëpiak prej datës 05.09.2009 deri më datën 27.08.2014 dhe dënimet e këtilla të shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjesisë penale të akuzuarve, intensitetit të vlerës së mbrojtur,- se është privuar nga jeta i ndjeri Q.H., si vlerë më e madhe e mbrojtjes penale-juridike dhe dënimi i këtillë të shqiptuara janë në proporcion me rrethanat e cekura më lartë dhe të njëjtat i shërbejnë preventivës individuale dhe asaj të përgjithshme dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pritët të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Nga kjo që u cekë më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 401 dhe 403 par. 1 të KPP-së,

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.279/2018, me datën 28.06.2018

Procesmbajtësi,

Besnike Miftari

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Tonka Berishaj